



**MALI I ZI**  
**KOMUNA E ULQINIT**  
**KOMISIONI PËR ALOKIMIN E MJETEVE ORGANIZATAVE JOQEVERITARE**

Numër: 01-1386/19-1  
Ulqin, më 02. 09. 2019

Në bazë të nenit 29, paragrafi 2 të Vendimit për kriteret, mënyrën dhe procedurën e alokimit të mjeteve organizatave joqeveritare („Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 42/18) Komisioni për alokimin e mjeteve organizatave joqeveritare shpallë

**THIRRJE PUBLIKE**  
**për zgjedhjen e vlerësuesve të pavarur në procesin e vlerësimit me pikë të projekteve dhe programeve të Organizatave joqeveritare për vitin 2019**

1. Objekt i thirrjes publike janë zgjedhja e dy vlerësuesve të pavarur, të cilët do të bëjnë vlerësimin me pikë të projekteve, përkatësisht programeve të organizatave joqeveritare, të cilët do të aplikojnë në Konkursin publik për alokimin e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Ulqinit për vitin 2019.
2. Kandidatët për vlerësues të pavarur duhet të plotësojnë këto kushte:
  - Shtetas i Malit të Zi,
  - Së paku 5 vite përvojë në administrimin e projekteve dhe
  - Përvojë në vlerësimin e projekteve.

Vlerësues i pavarur nuk mund të jetë personi i cili nuk ka dy vjet para publikimit të kësaj thirrje publike ka qenë: (?????)

- në marrëdhënie pune në një organizatë joqeveritare, selia e të cilës është në territorin e komunës,
- vullnetar në një organizatë joqeveritare selia e të cilës është në territorin e Komunës së Ulqinit,
- person i autorizuar për përfaqësim ose është anëtar i organit drejtues ose i një organi tjetër të organizatës joqeveritare selia e të cilës është në territorin e komunës,
- në marrëdhënie pune në një organ të administratës lokale, i cili bënë alokimin e mjeteve.

1. Kandidati për vlerësues i pavarur ia paraqet aplikimin në thirrjen publike Komisionit për alokimin e mjeteve OJQ përmes Zyrës (byrosë) së qytetarëve të Komunës së Ulqinit.

Me aplikacion dorëzohen edhe:



1. certifikata e nënshtetësisë,
2. fotokopja e letërnjoftimit ose një dokumenti tjetër në bazë të të cilit konfirmohet identiteti i kandidatit,
3. fotokopja e diplomës për arsimin e fituar,
4. një biografi e kandidatit me të dhënat për përvojën e administrimit të projekteve.

Afati për paraqitjen e aplikimeve është 30 ditë nga dita e publikimit të thirrjes publike.

Aplikimi i kandidatit për zgjedhjen e vlerësuesit të pavarur për vitin 2019 do të shqyrtohet vetëm nëse është dorëzuar në afatin e paraparë dhe me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Aplikimet e dorëzuara pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim.

1. Vlerësuesit të pavarur i takon kompensimi në shumën bruto prej 10 € për projektin e vlerësuar me pikë. Kompensimi në total për punën e vlerësuesit të pavarur nuk mund ta kalojë shumën bruto prej 1.000 €.

2. Pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të kërkuara në aplikime, Komisioni për alokimin e mjeteve OJQ-ve (në vazhdim të tekstit Komisioni) do të nxjerrë Vendimin për zgjedhjen e dy vlerësuesve të pavarur në procesin e vlerësimit me pikë të projekteve dhe programeve të OJQ-ve për vitin 2019 dhe do ta publikojë në Web sajtin e komunës, më së voni 15 ditë nga dita e përfundimit të thirrjes publike.

3. Kontratën me vlerësuesin e pavarur e lidhën Kryetari i Komunës.

4. Vlerësuesit e pavarur të zgjedhur janë të obliguar që para vlerësimit, të nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit, paanshmërisë dhe të mos ekzistimit të konfliktit të interesit në raport me projektet dhe programet që do të vlerësojë. Deklarata nënshkruhet pas shikimit të regjistrit të aplikimeve të projekteve dhe programeve të OJQ-ve.

5. Vlerësuesit e pavarur të zgjedhur do të njoftohen më vonë për detajet e procedurës në lidhje me mënyrën e vlerësimit me pikë të projektit.

Nga vlerësuesi i pavarur nuk mund të kërkohet marrja pjesë në mbledhjet e Komisionit, me qëllim të dhënies së përgjigjeve dhe sqarimit në pyetjet e mundshme të anëtarëve të Komisionit.

6. Kjo thirrje publike është publikuar në web sajtin e Komunës së Ulqinit, në tabelën e shpalljeve të Komunës së Ulqinit hde në transmetuesin lokal publik – RTUL.

7. Informata për të gjitha pyetjet e rëndësishme për të marrë pjesë në thirrjen publike mund të merren çdo ditë pune prej orës 7 – 15 në Sekretariatit për administratë dhe veprimtari shoqërore (zyra numër 119) dhe në tel.: 030-412-650.



KRYETARJA E KOMISIONIT  
Hadixha Gjoni

*H. Gjoni*